



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:040213

Datë: 14.10.2024

Numri i dokumentit: 06295163

**C-IV.-18-0016**

*Ankuesi:*

I A nga Fushë Kosova.  
Përfaqësuar nga Z Z av. nga Prishtina.

*Kundër:*

*E paditura:*

N.SH “Gërmia”, e përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rr. “Dritan Hoxha” nr. 55, Lakrishtë, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtarja Hajrie Shala, me dt.02 tetor 2024, lëshon këtë:

**A K T V E N D I M**

**1. HUDHET** ankesa e ankuesit dhe **VËRTETOHET** vendimi i Autoritetit të Likuidimit të AKP-së nr.PRN093-0025 i dt.25 qershor 2014.

**2.Nuk caktohen taksa gjyqësore për ankuesin.**

**Rrethanat faktike dhe procedurale**

Me dt.19 shtator 2014, ankuesi ish punëtor i NSH “Gërmia” ka ushtruar ankesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovë (më tej “Dhoma e Posaçme”) kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit (më tutje AL) nr. PRN093-0025 i dt.25 qershor 2014, me të cilin ka kërkuar kompensim për asistencë sociale. Ankesën e paraqet për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore, për shkak të zbatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Ankesës i ka bashkangjitur: Kopjen e vendimit të atakuar, Formularin e kërkesës për likuidim, Kopjen e

vendimit të përkohshëm mbi asistencën sociale nr.466 dt.04.06.2001, Kopjen e vendimit nr.892 dt.05.02.2003, Lista e punëtorëve në asistencë sociale I, II, III, IV, V, VI, VII, VIII, IX, X, XI, XII të 2005 Analiza e asistencës sociale të përfunduar me dt.21.12.2005.

Me dt.05 mars 2018, e paditura AKP-ja ka parashtruar mbrojtje në ankesë, në të cilën pohoi se ankesa e ankuesit është paraqitur jashtë afatit ligjor për paraqitje të ankesave. E njëjta është paraqitur tri vite e gjysmë pas pranimit të saj nga ankuesi. Gjithsesi e kundërshton në tërësi ankesën, dhe thekson se objekt i kësaj procedure është shkelja e mundshme ligjore e AL e konstatuar me vendimit të cilin e ka atakuar ankuesi. Ka kërkuar nga gjykata që të refuzoj ankesën e ankuesit. Në mbështetje të ankesës ka dorëzuar kopjen e vendimit të AL, Kopjen e kërkesës për dokumente shtesë, Kopjen e formularit për likuidim, Kopjen e vendimit nr.892 dt.05.02.2003, Kopjen e vendimit të përkohshëm mbi asistencën sociale nr.466 dt.04.06.2001, Fletëkthesën e Postës së Kosovës.

### **Arsyetime ligjor**

Hudhet si e pas afatshme ankesa e ushtruar kundër vendimit të AL nr. PRN093-0025 i dt.25 qershor 2014.

Neni 37.7. i Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, parasheh: “Kreditori i prekur ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata brenda tridhjetë (30) ditëve pas dhënies së njoftimit nga ana e Autoritetit të Likuidimit që të vendos për kërkesën e tij dhe mos kerkimi i tillë në kohë nga ana e kreditorit do ta pamundësojë atë në kundërshtimi i mëtejme i vendimit të Autoritetit të Likuidimit.”

Dhoma e Posaçme pasi ka shqyrtuar me kujdes ankesën dhe dokumentacionin përcjellës ka gjetur se ankesa nuk i përmbush kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në nenet 28.2.2.6 dhe 70.2 të Shtojcës së Ligjit për Dhomën e Posaçme dhe/ose nenin 37.7 të Shtojcës së Ligjit për AKP-në. Ankuesi nuk e ka dorëzuar ankesën në gjykatë brenda afatit prej 30 ditëve nga data kur ai ka pranuar vendimin e ankimuar. Sipas vendimit të ankimuar data e lëshimit të tij është 25 qershor 2014. E njëjta gjë dëshmohet edhe me fletëkthesën e Postës së Kosovës, ku është konstatuar se dërgesa është pranuar me dt.27 qershor 2014. Ankuesi dorëzoi ankesën e tij kundër vendimit në fjalë me 02 shkurt 2018, që do të thotë pas më tepër se tri vite pas afatit.

Për këtë në pajtim me nenet 28.1, 28.2, 28.3 dhe 70.2 të Shtojcës së Ligjit të Dhomës së Posaçme, Ankesa kundër Vendimit Autoritetit të Likuidimit të AKP-së nr. PRN093-0025 i dt.25 qershor 2014, për kompensim për shkak të asistencës sociale hedhet poshtë si e papranueshme.

Andaj në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54 par.1 dhe 74 par.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

### **Taksat gjyqësore**

Në bazë të nenit 62 par.3 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, secila palë do t'i bart shpenzimet e veta procedurale. Ankuesi e ka paguar taksën me dt.02 shkurt 2018.

### **Këshilla juridike**

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim tek Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme brenda 15 ditësh nga data e pranimit. Ankesa duhet të parashtrohet në bazë të nenit 9 par.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Gjyqtarja  
**Hajrie Shala**